



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik

UNIVERSITETI I MITROVICËS "ISA BOLETINI" MITROVICË

PLANI STRATEGJIK I FAKULTETIT EKONOMIK për vitin 2019-2021

21.03.2019, MITROVICË



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

Ky plan strategjik është përgatitur nga stafi i Fakulteti Ekonomik, Universiteti Mitrovicës, bazuar në kërkesën dhe udhëzimet e Senatit të UMIB-it

© 2017 Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Mitrovicës "ISA BOLETINI"

Adresa: Ukshin Kovaçica, 40000 Mitrovicë,

U. D. Dekan:

Besart Hajrizi, PhD (c)
Email: besart.hajrizi@umib.net
Tel: Mob: +377 45 204 343

U.D. Prodekan:

Prof.Ass.Dr.Qazim Tmava

Profesorët:

Profesor i rregullt: Prof.Dr.Isa Tahiri

Profesorë asistentë:

1. Prof.Ass.Dr.Shefket Jakupi,
2. Prof.Ass.Dr.Ajtene Avdullahi
3. Prof.Ass.Dr.Esat Durguti,
4. Prof.Ass.Dr.Bashkim Bellaqa

Asistentë:

1. Ylber Januzaj, PhD (c)
2. Filloreta Kunoviku Demiri, PhD (c)
3. Besë Sadikaj, PhD stud.
4. Milaim Mehmeti, Mr.
5. Arif Krasniqi, Mr.



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

Përmbajtja

1	HYRJE.....	1
2	Profili dhe themelimi i Fakultetit Ekonomik.....	2
2.1	Procesi i akreditimit Fakultetit Ekonomik	4
2.1.1	Nivelet / Programet e kërkuara nga tregu i punës.....	5
	<i>Specializimi: MSc në Financa, Banka dhe Kontabilitet</i>	<i>11</i>
	<i>Specializim: MSc në Menaxhment, Inovacione dhe Ndërmarrësi.....</i>	<i>11</i>
	<i>Specializim: MSc në Menaxhment, inovacione dhe ndërmarrësi.....</i>	<i>11</i>
2.2	Rekrutimi i stafit akademik	13
2.3	Puna e hulumtimeve shkencore në kuadër të FE.....	14
2.4	Krijimi i sistemit ALUMNI.....	16
2.5	Autonomia e Njesisë Akademike FE	16
2.6	Mbrojtja nga diskriminimi	16
3	VIZIONI DHE MISIONI I FAKULTETIT EKONOMIK.....	17
3.1	Vizioni i FE	17
3.2	Misioni i FE.....	17
3.3	Udhëheqja, menaxhimi dhe marrëveshjet e administratës dhe personelit	19
4	PËRMBLEDHJA E STRATEGJIVE KRYESORE DHE INICIATIVAT STRATEGJIKE 19	
4.1	Objektivat dhe qëllimet e përgjithshme të zhvillimit të FE	19
5	FUSHAT STRATEGJIKE DHE INICIATIVAT STRATEGJIKE	20
5.1	Mësimdhënia, Mësimënxënia kërkimi dhe shërbimi	20
5.2	Burimet e mësimit dhe mbështetja e studentëve	22
5.3	Sigurimi i cilësisë	22
5.4	Regjistrimi i studentëve në FE	26
5.5	Zhvillimi i burimeve njerëzore.....	26
5.6	Zhvillimi i sistemit për informim publik.....	27
5.7	Globalizimi / Ndërkombëtarizimi	27
6	MONITORIMI, VLERËSIMI, DHE RAPORTIMI.....	28
7	PËRFUNDIM.....	29
8	Shtojca	30



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

LISTA E AKRONIMEVE

KD	Këshilli Drejtues
PSUMIB	Plani Strategjik i Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”
UMIB	Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”
SA	Stafi akademik
ZSC	Zyra për Sigurim të Cilësisë
ZIKP	Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun
PA	Parlamenti Studentor
SI	Sistemi informativ
TI	Teknologjia informative
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit
NJAFK	Njësia Akadematike Fakultetit Ekonomik
PSFE	Plani Strategjik I fakultetit Ekonomik



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

DOKUMENTET E KONSULTUARA:

Hartimi i dokumentit Plani Strategjik i Fakultetit Ekonomik, Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”, është përpiluar mbështetur në dokumentet dhe në raportet ekzistuese të e cekura si më poshtë :

- PLANI STRATEGJIK I UNIVERSITETIT TË MITROVICËS “ISA BOLETINI”
- 2018-2021
- Statuti i Përkohshëm i UMIB-it;
- Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 të Qeverisë së Kosovës;
- Ligji për Arsimin e Lartë i Republikës së Kosovës, 2010;
- Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021;

Andaj objektivat strategjike të Fakultetit Ekonomik korrespondojnë me objektivat e këtyre strategjive nacionale.



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

1 HYRJJE

Planifikimi strategjik përdoret për të përcaktuar misionin, visionin, vlerat, strategjite për të arritur qëllimet dhe objektivat.

Planit Strategjik është hartuar në përputhje me Strategjinë në kuadër të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini" duke i'u përshtatur misionit, vizionit, orientimit, dhe objektivave të universitetit. Fakulteti Ekonomik është kujdesur që përmes këtij plani të paraqes objektivat e tij kyçe për zhvillim në vitet në vazhdim.

Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini" vazhdon të mbetet i përkushtuar në përmbushjen e objektivave afatgjata të investimit në gjeneratën e re të ekonomistëve, investim nga i cili, përveç vetë studentëve, do të përfitojnë të gjithë ata të cilëve do u shërbejnë këtë ta fundit. Nëpërmjet programit të vet, Fakulteti Ekonomik do të vazhdoj të kontribuoj në plotësimin e nevojave për ekonomistë profesionistë, të gatshëm për tu përballur me kërkesat e tregut të punës, dhe për t'iu përgjigjur në mënyrë adekuate kërkesave të komunitetit dhe nevojave të përgjithshme të shoqërisë kosovare.

Ky plan është shkruar duke konsideruar një numër të madh faktorësh të cilët kanë ndikuar në formën e tij finale. Ndër këta faktor rol kyç në përpilimin e këtij dokumenti kanë luajtur analiza e thukët e programeve që ofrohen në të gjitha universitetet në Kosovë e rajon, analizat profesionale të stafit akademik aktualisht të punësuar në Universitetin e Mitrovicës, konsultimet me studentë të fushës ekonomike, si dhe të dhëna nga kërkesat e tregut të punës e hulumtuar nga personat e angazhuar në përpilimin e kësaj strategjie.

Strategjia është e përpiluar në atë formë që të ofroj të dhëna për profilin e Fakultetit Ekonomik, duke përfshirë misionin dhe visionin mbi të cilin funksionon ky program studimesh. E gjithëstrategjia mbështetet në tri shtylla kryesore zhvillimi: planifikimi për studentët e rinjë; planifikimi për hulumtim dhe organizime brenda fakultetit; sigurimi i cilësisë dhe avansimi i vet stafit akademik tashmë të punësuar apo ata që mëtojnë të punësohen në këtë program.

Natyra pjesëmarrëse e Planit Strategjik garanton vazhdimësinë dhe legjitimitetin e strategjisë së zhvillimit. Fakti që kjo strategji u propozua nga shumica e stafeve akademike dhe administrative duhet të merret parasysh nga administratorët aktualë dhe të ardhshëm për të përmbushur pritshmëritë e komunitetit të studentëve dhe stafit akademik FE, për periudhën 3 vjeçare.

Ky dokument paraqet një përmbledhje të procesit të planifikimit strategjik të kryer në Fakultetin Ekonomik. Gjithashtu, ky plan strategjik shpjegon se si është aplikuar metodologjia e planifikimit strategjik në FE konform Planit Strategjik të UMIB-it, mënyrën se si FE planifikon për rezultatet që do të arrijë e arritura.



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

Planifikimi Strategjik do të konsiderohet si proces i rishqyrtimit dhe vlerësimit i shoqëruar vazhdimisht nga procedurat e monitorimit, komunikimit dhe pjesëmarrjes.

Informimi: FE e nisi procesin e Planifikimit Strategjik me një prezantim të kësaj nisme tek stafi akademik, ndihmës akademik gjatë mbledhjeve të departamenteve dhe fakulteteve ku dhe u dorëzuan materialet udhëzuese për ndërtimin e këtij plani, duke theksuar qëllimin e tij dhe instrumentat për ta realizuar atë.

FE si njësitë bazë përfshinë në një proces informimi rreth rëndësisë së hartimit të një Plani Strategjik, metodologjisë duke përfshirë qasjen për të identifikuar problematikat dhe prioritetizuar ndërhyrjet strategjike.

Identifikimi: U realizua identifikimi i target-grupeve që do të përfshiheshin në një proces të gjerë konsultimesh në njësinë akademike të FE, përfshirë këtu edhe grupet e interesit që në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë ndikojnë në politikat e zhvillimit të FE dhe Universitetit dhe që natyrshëm u bënë pjesë aktive e diskutimit dhe konsultimit rreth prioriteteve të zhvillimit në përputhje me trendin e zhvillimit social ekonomik rajonal, kombëtar dhe Europian.

2 Profili dhe themelimi i Fakultetit Ekonomik

Fakulteti Ekonomik në kuadër të Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" (UMIB) ka filluar punën në vitin akademik 2013-14 në dy drejtime: Banka Financa dhe Kontabilitet; Menaxhment dhe Informatike si njësi akademike e UP në Prishtinë, në vitin akademik 2014-15, startoi si njësi e pavarur akademike në kuadër të UMIB-it.

Fakulteti Ekonomik, për vitin akademik 2015-16 shpalli konkursin për studentë të rregullt në dy drejtime: Banka, Financa dhe Kontabilitet si dhe në Menaxhment dhe Informatikë, për 220 vende ku 200 vende ishin për studentë nga Kosova, 10 vende për komunitetet: boshnjak, turq, rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe 10 vende për: Preshevë, Bujanoc, Mal të Zi, Shqipëri dhe Maqedoni.

Duke u nisur nga nevoja e domosdoshme për organizimin dhe zhvillimin e arsimit të lartë sipas standardeve dhe kritereve të universiteteve evropiane dhe më gjerë, Fakulteti Ekonomik në kuadër të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë ka dizajnuar modelin e studimeve të reformuara sipas planeve dhe programeve të mbështetura në rekomandimet e Deklaratës së Bolonjës.

Deklarata e Bolonjës thotë: "Rëndësia e arsimit dhe bashkëpunimi arsimor për zhvillimin dhe forcimin e shoqërive të qëndrueshme, paqësore dhe demokratike në përgjithësi konsiderohet një arritje e madhe, e veçanërisht në lidhje me situatën në Evropën Juglindore".

Nga viti akademik 2015-16 në Fakultetin Ekonomik organizohen studimet sipas plan programeve të miratuara nga Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini" të mbështetura në Deklaratën e Bolonjës.



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

Në vitin akademik 2015-16 Agjensioni i Akreditimit ka akredituar të gjitha planet mësimore të Fakultetit në studimet Bachelor (për të dy departamentet: Banka, Financa dhe Kontabilitet dhe Menaxhment dhe Informatikë).

Themelet e studimeve të Fakultetit Ekonomik u vunë me hapjen e Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini" në Mitrovicë më 06.03.2013. Duke u nisur nga nevoja e domosdoshme për organizimin dhe zhvillimin e arsimit të lartë sipas standardeve dhe kriterëve të Universiteteve Evropiane dhe më gjerë, Fakulteti Ekonomik në Mitrovicë në kuadër të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë propozon modelin e studimeve të reformuara sipas planeve dhe programeve të mbështetura në rekomandimet e Deklaratës së Bolonjës.

Studimet në Fakultetin Ekonomik me akreditimin e kaluar janë të organizuara në dy Departamente: Banka, Financa dhe Kontabilitet dhe Menaxhment dhe Informatikë. Në kuadër të secilit departament studentët në vitin e parë kanë lëndët e njëjta, për t'u diversifikuar prej vitit të dytë e tutje.

Tabela 1: Regjistrimi i studentëve në vitin shkollor 2014-15

Programet e studimit për vitin shkollor 2014-15 në:					
<ul style="list-style-type: none">• Banka, Financa dhe Kontabilitet• Menaxhment dhe Informatikë					
Niveli Bachelor-Drejtimi	Nr. studentëve me korrespond.	Nr. i studentëve të rregullt	Gjithsejt	M	F
BFK	-	98	98	57	41
M dhe I	-	89	89	59	30
Total		187	187	116	71

Tabela 2: Regjistrimi i studentëve në vitin shkollor 2015-16

Programet e studimit për vitin shkollor 2015-16 në:					
<ul style="list-style-type: none">• Banka, Financa dhe Kontabilitet• Menaxhment dhe Informatikë					
Niveli Bachelor-Drejtimi	Nr. studentëve me korrespond.	Nr. i studentëve të rregullt	Gjithsejt	M	F
BFK	-	100	100	61	39
M dhe I	-	104	104	77	27
Total		204	204	138	66



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

Tabela 3: Regjistrimi i studentëve në vitin shkollor 2016-17

Programet e studimit për vitin shkollor 2016-17 në:					
• Banka, Financa dhe Kontabilitet					
• Menaxhment dhe Informatikë					
Niveli Bachelor-Drejtimi	Nr. studentëve me korrespond.	Nr. i studentëve të rregullt	Gjithsejt	M	F
BFK	-	102	102	63	39
M dhe I	-	100	100	74	26
Total	-	202	202	137	65

Propozimi i këtyre planeve dhe programeve studimore të Fakultetit Ekonomik ka për qëllim realizimin e këtyre objektivave:

- Nevojën e reformimit të planeve dhe programeve dhe harmonizimin e tyre me atë të shteteve të Bashkësisë Evropiane si imperativ i kohës.
- Përsosjen e planeve dhe programeve ekzistuese dhe begatimi i tyre me përvojën e Fakulteteve të ngjashme të Bashkësisë Evropiane dhe më gjerë.
- Reformimin e regjimit të studimeve, hapjen e mundësive për këmbimin e studentëve.
- Rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së studimeve me anë të zbatimit të metodave bashkëkohore të ligjërimit dhe të vlerësimit të njohurive të studentëve.
- Shfrytëzimin e potencialit kadrovik ekzistues dhe të atij që shkollohet në botën e jashtme.
- Përmirësimin e programeve të studimeve, duke i liruar studentët nga studimi (mesimi) i temave të tepërta dhe të panevojshme.

2.1 Procesi i akreditimit Fakultetit Ekonomik

Procesi i akreditimit do të diktoj një reflektim të FE në lidhje me ndryshimet në strategjinë e drejtimit dhe menaxhimit të FE, duke rritur efektivitetin e përdorimit të aseteve të tij në burime njerëzore, infrastrukture, shërbime mbështetëse për studentet, burimet financiare të tij, partneritete kombëtare, nderkombëtare, duke patur në konsideratë pozicionin strategjik gjeografik të tij. Procesi ndihmon ndjeshëm në zhvillimin e një sërë parimesh të përgjithshme për zhvillim si dhe hartimit të një sërë praktikash dhe udhëzimesh në funksion të rritjes së efektivitetit të FE. Në Fakultetin Ekonomik, sigurimi i cilësisë bazohet në:

- Udhërrëfyesin për Sigurimin e Cilësisë së UMIB, i aprovuar nga Senati i UMIB-it, në pajtueshmëri edhe me Statutin e tij.
- Në rregulloret e brendshme të Fakultetit Ekonomik që do të miratohen nga Këshilli Mësimor-Shkencor,
- Urdhërrëfyesin sipas Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë

Do të sigurohet cilësia e programeve për sigurim të akreditimit të vazhdueshëm të tyre duke:

- Ndërtuar një sistem të brendshëm të sigurimit të cilësisë në kuadër të Njesisë Akademi FE në harmoni me të sigurimin e cilësisë UMIB-it;



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

- Analizuar dhe mbikëqyrur vazhdimisht mbarëvajtjen e programeve në kuadër të FE;
- Ofron programe të reja varësisht prej nevojave të tregut të punës dhe përgatitjes sa më të mire të studentëve për tregun e punës;
- Mbikëqyrur dhe vlerësuar angazhimin e stafit akademik të FE;
- Përmirësimi i mësimdhënies dhe mësim nxënies për të arritur rezultate më të mira të mësimin në FE;
- Rritja e cilësisë së stafit akademik FE, progresit të studentëve, vlerësimin e lëndëve dhe rezultatet e përgjithshme;
- Zhvillimi dhe zbatimi i sistemit të matjes së rezultateve të studentëve të FE;
- Rritja dhe përmirësimi i rezultateve kërkimore në FE konform UMIB;
- Përforcimi i marrëdhënieve të Universitetit me botën e punës dhe të shoqërisë civile;
- Fillimi i punës për zhvillimin e programit të bachelorit dhe të Masterit në FE në përputhje me sistemin e Bolonjës;
- Institucionalizimi i përfshirjes së studentëve në sigurimin e cilësisë.

Studimet në akreditimin e programit e ri **Biznes dhe Menaxhment**, FE që nga viti akademik 2018-19 do ta ketë një program **Biznes dhe Menaxhment** me dy specializime të specifikuar si më poshtë :

- Financa , Banka dhe Kontabilitet (BSc),
- Menaxhment, Inovacione dhe Ndërmarrësi (BSc), të cilat ndahen nga semestri i katërt.

Viti akademik në FE përbëhet nga dy semestra me shtrirje në 15 javë secili. Kjo ndarje vlen për të dy nivelet e studimit në FE. Semestri i parë përfshin periudhën Tetor – Janar dhe semestri i dytë periudhën shkurt - qershor. Forma e studimit është e rregullt.

2.1.1 Nivelet / Programet e kërkuara nga tregu i punës

Programi Biznes dhe Menaxhment me specializimet: Financa , Banka dhe Kontabilitet (**BSc / MSc**), Menaxhment, Inovacione dhe Ndërmarrësi (**BSc/MSc**), është i projektuar për të pajisur studentët me njohuri, aftësi dhe eksperiencë, që ti ndihmojnë të diplomuarit të hyjnë me sukses në botën e profesioneve që të përdorin aftësi të kultivuara në këtë program, si p.sh. në biznes, menaxhmet, ndërmarrës, inovator, bankier, kontabilist, analist kredie, analist financiar, apo për të vazhduar studime të mëtejshme pasuniversitare në fushat përkatëse.

Për këtë qëllim, kurrikulat hartohen dhe modulet e tyre strukturohen mbështetur në eksperiencën akademike dhe profesionale të stafit akademik, brenda dhe jashtë FE, si dhe në përvojat e të diplomuarve.

Programi i Biznes dhe Menaxhment ofron një program studimor duke u mbështetur në kurrikulat bashkëkohore, më të arriturat shkencore dhe kërkimet që realizohen në biznes dhe menaxhment. Niveli i arritjes profesionale dhe bazat shkencore që arrijnë studentet në këtë fakultet, janë solide për zhvillimin e biznesit në fushën e ekonomisë.

Po ashtu, bazat e fituara në studimet themelore në këtë program studimi përgatitin kuadro për nevojat e tregut, për institute hulumtuese, në institucione dhe në ndërmarrje publike dhe e private



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

si në vend, rajon por edhe në botën e jashtme, si dhe në procesin arsimor për arsimimin e kuadrove të ardhshme nga lëmi i Menaxhmentit, Inovacioneve dhe Ndërmarrësisë si dhe Financa, Banka dhe Kontabilitet.

Programi i studimit është modeluar bazuar në objektivat e kualifikimit. Këto përfshijnë aspekte të lidhura me lëndët dhe ndërdisiplinore si dhe përvetësimin e shkathtësive dhe kompetencave disiplinore, metodologjike dhe gjenerike.

Programi i studimit i referohet kompetencave akademike, aftësisë për të marrë punësim adekuat për plotësimin e nevojave të tregut të punës, aftësisë për të marrë punësim adekuat duke gërshëtuar aspektin teorik me atë praktik dhe zhvillimin e personalitetit të studentëve në fushat e specializimit.

Prandaj programi është i hapur për këdo që synon të ndërtojë njohuritë në Biznes dhe Menaxhment, në veçanti për një karrierë të lidhur me këto fusha të specializimit.

Programi ofrohet në përputhje me nevojat e tregut të punës:

- Programi i studimit synon të plotësojë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.

Fakulteti Ekonomik, bazuar në hulumtimin e nevojave të tregut të punës nga institucionet kredibile në vend shqyrtoi:

- mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar a ndërkombëtar;
- kërkesat e punëdhënësve;
- një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;
- numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme

Lidhje më intensive me subjektet ekonomike në regjion të cilët janë të interesuar drejtpërdrejt në edukimin e profesionistëve sa më të mire, të cilët përveç kualifikimeve cilësore të njohurive të arritura në nivele të caktuara të arsimit, gjithashtu sigurojnë bashkëpunim cilësor të biznesit në fushën e mësimdhënies.

- Zhvillimin e një sistemi të arsimit të përjetshëm në përputhje me nevojat e tregut;
- Zhvillimi i rezultateve të matshme të programit;
- Rritja e bashkëpunimit me sektorin publik dhe privat për t'i lidhur programet me kërkesën, aftësitë aktuale dhe kërkesat e njohurive dhe nevojat e ardhshme.

Në vijim, prezantojmë të dhënat për programin **Biznes dhe Menaxhment**, me dy specializimet në nivelin Bachelor

Tabela 4: Të dhënat bazike për programin në nivel bachelor (BSc):

Emri i programit të studimit	BIZNES DHE MENAXHMENT
------------------------------	------------------------------



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

Niveli i kualifikimit sipas KKK me shkurtesat (BSc)	Bachelor i shkencave (BSc)
Grada akademike dhe emërtimi i diplomës në formë të plotë dhe të shkurtuar	Bachelor në Biznes dhe Menaxhment Specializimi: Financa, Banka dhe Kontabilitet (BSc në Biznes dhe Menaxhment- Financa, Banka dhe Kontabilitet), & Bachelor në biznes dhe menaxhment Specializimi: Menaxhment, Inovacione dhe Ndërmarrësi (BSc në Biznes dhe Menaxhment - Menaxhment, inovacione dhe ndërmarrësi),
Fusha e studimit sipas Erasmus Subject Area Codes (ESAC)	04.9
Profili i programit akademik (specializimet)	Biznes dhe Menaxhment Specializimet: <ul style="list-style-type: none"> • Financa, Banka dhe Kontabilitet (BSc), • Menaxhment, Inovacione dhe Ndërmarrësi (BSc),
Kohëzgjatja minimale e studimit	Tri (3) vite / gjashtë (6) semestra
Forma e studimit (e rregullt, pa shkëputje nga puna, studim në distancë etj.)	Rregullt
Numri i ECTS kredive (total dhe për vit)	180 ECTS
Modulet /Lëndët (titujt)	<p style="text-align: center;">Biznes dhe Menaxhment Viti i parë – semestri I</p> <ul style="list-style-type: none"> O Mikroekonomi O Parimet e menaxhmentit O Matematika financiare O Informatika biznesore O Gjuhe e huaj I (Gjuhe angleze I) <p style="text-align: center;">Viti i parë – semestri i II</p> <ul style="list-style-type: none"> O Makroekonomia O Parimet e kontabilitetit O Statistika biznesore Z Ekonomia e Kosovës dhe BE-së Z Menaxhimi i informacionit dhe teknologjisë <p style="text-align: center;">Viti i dytë – semestri III</p> <ul style="list-style-type: none"> O Financa



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

	<ul style="list-style-type: none">O Parimet e marketingutO Kontabiliteti MenaxherialO E drejta biznesoreZ Financat NdërkombëtareZ Biznesi elektronikZ Anglishtja biznesore <p style="text-align: center;">Viti i dytë - semestri IV</p> <p style="text-align: center;"><u>Specializimi: Financa, Banka, dhe Kontabilitet</u></p> <ul style="list-style-type: none">O Kontabiliteti financiar dhe raportimiO Bankat dhe afarizmi bankarO Financat e korporataveO Financat publikeZ Menaxhimi kulturorZ Menaxhimi i NVM-veZ Ndërmarrësia <p style="text-align: center;">Viti i tretë – semestri V</p> <ul style="list-style-type: none">O Menaxhmenti financiarO Tregjet dhe Institucionet financiareO Menaxhmenti bankarO Menaxhimi i resurseve humaneZ Kontabiliteti buxhetorZ Financat personaleZ Kontabiliteti tatimor <p style="text-align: center;">Viti i tretë - semestri VI</p> <ul style="list-style-type: none">O Parimet e auditimitO Analiza e pasqyrave financiareO Financat publikeO Menaxhimi i riskut dhe sigurimeveZ Analiza e të dhënave për hulumtime në biznesZ Kontabiliteti aplikativ në biznesZ Puna praktikeO Punim diplome <p style="text-align: center;">Viti i dytë - semestri IV</p>
--	--



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

	<p style="text-align: center;"><u>Specializimi: Menaxhment, Inovacione dhe Ndërmarrësi</u></p> <p>O Ndërmarrësi O Menaxhimi i NVM-ve O Menaxhimi i operacioneve O Sjellje organizative Z Dizajnimi dhe implementimi i databazave Z Menaxhimi kulturor Z Komunikimi në biznes</p> <p style="text-align: center;">Viti i tretë - semestri V</p> <p>O Menaxhimi i resurseve humane O Menaxhimi i inovacioneve O Menaxhimi i projekteve O Menaxhimenti financiar Z Menaxhimi i investimeve Z Menaxhimi i kohës Z Menaxhimi i dijes</p> <p style="text-align: center;">Viti i tretë - semestri VI</p> <p>O Menaxhmenti strategjik O Menaxhimi i biznesit ndërkombëtar O Teknologjia informatike dhe planifikimi i projekteve O Vendosija në biznes Z Analiza e të dhënave për hulumtime në biznes Z Etika në biznes Z Pune praktike O Punim diplome</p>
Numri i vendeve të studimit	200 për vit
Udhëheqës i drejtimit / programit të studimit	Prof.Ass.Dr. Shefket Jakupi
Personeli i përhershëm shkencor/artistik (Numri sipas kategorive të personelit)	<p>Profesor i rregullt: Prof.Dr. Isa Tahiri Profesorë të asocuar: 0 Profesorë asistentë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Prof.Ass.Dr.Qazim Tmava, 2. Prof.Ass.Dr.Ajtene Avdullahi, 3. Prof.Ass.Dr.Esat Durguti, 4. Prof.Ass.Dr.Bashkim Bellaqa <p>Asistentë:</p>



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

	<ol style="list-style-type: none"> 1. Besart Hajrizi, PhD cand 2. Ylber Januzaj, PhD cand 3. Filloreta Kunoviku Demiri, PhD cand 4. Besa Sadikaj, PhD stud. 5. Milaim Mehmeti, Msc. 6. Arif Krasniqi, Msc.
Taksat e studimit	25€për semester; 50€për vit

Në vijim, prezantojmë të dhënat për programin **Biznes dhe Menaxhment** me dy specializimet në nivelin Master.

Tabela 5: Programi Biznes dhe Menaxhment (MSc)

Emri i programit të studimit	Biznes dhe Menaxhment
Niveli i kualifikimit sipas KKK me shkurtesat (MSc)	Master i shkencave (MSc)
Grada akademike dhe emërtimi i diplomës në formë të plotë dhe të shkurtuar	Master në biznes dhe menaxhment Specializimi: Financa, Banka dhe Kontabilitet. (MSc në Biznes dhe Menaxhment- Banka Financa dhe Kontabilitet), & Master në biznes dhe menaxhment Specializimi: Menaxhment, inovacione dhe ndërmarrësi. (MSc në Biznes dhe Menaxhment - Menaxhment, inovacione dhe ndërmarrësi),
Fusha e studimit sipas Erasmus Subject Area Codes (ESAC)	04.9
Profili i programit akademik (specializimet)	Biznes dhe Menaxhment Specializimet: <ul style="list-style-type: none"> • Financa, Banka dhe Kontabilitet (MSc), • Menaxhment, inovacione dhe ndërmarrësi (MSc),
Kohëzgjatja minimale e studimit	Dy (2) vite
Forma e studimit (e rregullt, pa shkëputje nga puna, studim në distancë etj.)	I rregullt - pa shkëputje nga puna
Numri i ECTS kredive (total dhe për vit)	Total :120 ECTS Në Vit : 60 ECTS
Numri i vendeve të studimit	<ul style="list-style-type: none"> • Banka Financa dhe Kontabilitet (MSc):60 student • Menaxhment, inovacione dhe ndërmarrësi (MSc): 60 student • Total= 120 student për dy specializimet



Modulet /Lëndët (titujt)	<p style="text-align: center;">BIZNES DHE MENAXHMENT</p> <p style="text-align: center;">Viti i parë – semestri I</p> <ul style="list-style-type: none">O Metodologjia e hulumtimeveO Teoria dhe praktika të menaxhmentitO Financat e avancuaraO Kontabiliteti financiar i avancuarZ Menaxhmenti financiar i avancuarZ Menaxhimi i NVM dhe ndërmarrësia <p style="text-align: center;">Viti i parë – semestri i II</p> <p><i>Specializimi: MSc në Financa, Banka dhe Kontabilitet</i></p> <ul style="list-style-type: none">O Menaxhmenti strategjikO Financat e korporatave të avancuaraO Kontabiliteti i avancuar menaxherial dhe i kostosZ Menaxhimi i riskut financiar dhe sigurimetZ Kontabiliteti i institucioneve financiare <p><i>Specializim: MSc në Menaxhment, Inovacione dhe Ndërmarrësi</i></p> <ul style="list-style-type: none">O Menaxhmenti strategjikO Menaxhimi i kreativitetit dhe inovacionetO Qeverisja KorporativeZ Menaxhimi i resurseve humane të avancuaraZ Menaxhimi i biznesit ndërkombëtar <p style="text-align: center;">Viti i dytë - semestri III</p> <p><u>Specializimi: Financa, Banka dhe Kontabilitet</u></p> <ul style="list-style-type: none">O Analiza dhe raportimet financiareO Paraja, banka dhe institucionet financiareO Auditimi i avancuarZ Bankingu modernZ Analiza e Investimeve dhe Menaxhimi i Portfolios <p style="text-align: center;">Viti i dytë - semestri III</p> <p><u>Specializim: MSc në Menaxhment, inovacione dhe ndërmarrësi</u></p> <ul style="list-style-type: none">O Menaxhimi i ndryshimit dhe menaxhimi i kohësO Lidershipi kreativO Menaxhimi i projekteve dhe investimet
--------------------------	---



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

	Z Analiza e Investimeve dhe Menaxhimi i Portfolios Z Negocimi në biznes Viti i dytë – semestri IV <ul style="list-style-type: none">Specializimi: Financa, Banka dhe kontabilitetSpecializimi: Menaxhment, inovacione dhe ndërmarrësi O Punim diplome
Udhëheqësi i drejtimit / programit të studimit	Profesor i rregullt: Prof.Dr. Isa Tahiri
Personeli i përhershëm akademik / artistik (Numri sipas kategorive të personelit)	Profesor i rregullt: Prof.Dr. Isa Tahiri Profesorë të asocuar: 0 Profesorë asistentë: 5. Prof.Ass.Dr.Qazim Tmava, 6. Prof.Ass.Dr.Shefket Jakupi, 7. Prof.Ass.Dr.Esat Durguti, 8. Prof.Ass.Dr.Ajtene Avdullahi 9. Prof.Ass.Dr.Bashkim Bellaqa Asistentë: 7. Besart Hajrizi, PhD cand 8. Ylber Jonuzaj, PhD cand 9. Filloreta Kunoviku Demiri, PhD cand 10. Besa Sadikaj, PhD stud. 11. Milaim Mehmeti, MSc, 12. Arif Krasniqi, MSc
Taksa e studimit	150 € për semestër

FE bazohet dhe përmush kërkesat e legjislacionit në fuqi, mbështetet njëkohësisht edhe në eksperiencat më të mira, kryesisht ato ndërkombëtare. Qëllimi themelor në fushën e mësimdhënies është transmetimi tek studentët i një informacioni sa më cilësor e bashkëkohor në të gjitha disiplinat mësimore në aspektin teorik dhe praktik, duke realizuar ciklin «**informacion-njohuri-dije-aftësi**».

Qëllimi bazë i mësimdhënies është përgatitja e studentëve cilësorë, të aftë që të analizojnë dhe konkludojnë në mënyrë të pavarur, dhe të debatojnë për marrjen e vendimeve të drejta.

Ky objektivi realizohet: (1) duke përpunuar dhe seleksionuar programe disiplinash sa më cilësore për çdo lëndë; (2) duke përdorur si literaturë bazë dhe plotësuese libra, autorë, të njohur në nivel kombëtar e ndërkombëtar; (3) zhvillimi i ligjëratave dhe ushtrimeve bëhet me metoda didaktiko – pedagogjike, moderne e interaktive, analizat krahasuese e kontekstuale, pjesëmarrjen aktive të studentëve në leksione e seminare, debatin e improvizuar, etj; (4) trajnimi i vazhdueshëm i stafit pedagogjik dhe atij ndihmës administrativ nëpërmjet seminareve, workshopeve e konferencave, për të qenë sa më performant në realizimin e objektivave të mësipërme; (5) zhvillimi i një pune të



gjerë e me kontakte të vazhdueshme me studentët për t'iu shpjeguar qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies në FE, dhe njëkohësisht për t'i bërë ata sa më aktivë në këtë proces.

Tabela 6: Programi Biznes dhe Menaxhment, në vitin shkollor 2019-20 planifikon të regjistrojë si në vijim:

Niveli Bachelor	Nr. studentëve me korrespod.	Nr. i studentëve të rregullt	Gjithsejt
Specializimi: FBK	0	100	100
Specializimi: MIN	0	100	100
Total	0	200	200

Studentët përcaktohen për specializim prej semestrit të IV.

2.2 Rekrutimi i stafit akademik

Fillimisht personeli akademik i FE është angazhuar nga UMIB-i, në marrëdhënie të rregullt pune dhe UP në marrëdhënie sekondare të punës në bazë të marrveshies në mes të këtyre dy institucioneve. Në vitin akademik 2016-17 në Fakultetin Ekonomik kemi përzgjedhur edhe 5 mësimdhënës të rregullt dhe asistentë të rregullt që janë paraqitur në tabelën në vijim sipas thirrjes së tyre akademike dhe shkencore.

Stafi mësimor FE është i kualifikuar me grada shkencore Doctor dhe thirrje akademike Prof.Dr., Prof.Asoc.Dr. dhe Prof.Ass., në përputhje me kërkesat ligjore lidhur me profesionin e pozitave mësimore të parapara sipas Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë Republikën e Kosovës, të dates 28.09.2018

Profesorët:

Profesor i rregullt: Prof.Dr.Isa Tahiri

Profesorë asistentë:

1. Prof.Ass.Dr.Shefket Jakupi,
2. Prof.Ass.Dr.Ajtene Avdullahi
3. Prof.Ass.Dr.Esat Durguti,
4. Prof.Ass.Dr.Bashkim Bellaqa

Asistentë:

1. Besart Hajrizi, PhD (c)
2. Ylber Januzaj, PhD (c)
3. Filloreta Kunoviku Demiri, PhD (c)
4. Besë Sadikaj, PhD stud.
5. Milaim Mehmeti, Mr.
6. Arif Krasniqi, Mr.

Të gjitha të dhënat lidhur me personelin mbahen duke respektuar natyrën e tyre private, kurse mund të hapen vetëm për qëllime të caktuara në pajtim me ligjin në fuqi dhe sipas dispozitave nenit 210 të Statuti përkohshëm të UMIB-it .



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

2.3 Puna e hulumtimit shkencor në kuadër të FE

Stafi akademik i FE do të shfrytëzojë të gjitha marvshjet ndëruniversitare me Universitetet lokale dhe ndërkombtare mes UMIB-it dhe universiteteve tjera. Së voni UMIB-I ka nënshkruar 36 memorandume të mirkuptimit (MiM) me IAL-të jashtë Kosovës.

UMIB-I ka formuar zyrën e projekteve "Erasmus +", që prezenton grupin punues të stafit akademik të cilët në baza vullnetre bashkëpunojnë në shumë aplikacione dhe projekte përmes "Erasmus +", të cilët njëherit janë duke punuar edhe në riaktivizimin e institutit hulumtues në nivel Universiteti. Brenda këtij grupi, stafi i FE në mënyrë aktive merret pjesë. Kemi aplikuar në shumë projekte hulumtuese me Universitetet Brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe FE ka organizuar truezën e rrumbullakët "IAL te konform kërkesave regjionale dhe internacionale të tregut të punës". Në këtë truezë kanë marrë pjesë përfaqësuesit e të gjitha universiteteve publike, përfaqësuesit nga Ministria e Inovacioneve dhe Ndërmarrësis, OEK, si dhe përfaqësuesit nga industria (biznese nga regjioni i Mitrovicës).

<http://umib.net/2018/04/tryeze-e-rrumbullaket-per-arsimin-e-larte-konform-kerkesave-te-tregut/>

<https://umib.net/2017/06/perfundoi-sukses-trajnimi-ne-kontabilitet-softuer/>

FE me programin Biznes dhe Menaxhment zhvillon punën e hulumtimit shkencor si pjesë integrale në kuadër të aktiviteteve akademike. Kështu stafi akademik si bartës i programit është i kualifikuar dhe përbëhet nga doctor të shkencave, PhD c si dhe Master në ekonomi të cilët kanë publikuar numër të konsiderueshëm librash, artikuj shkencor dhe kanë marrë pjesë në numër të konsiderueshëm të konferencave Brenda dhe jashtë vendit. Kjo në fakt prezanton anën e fortë të programit në punën hulumtuese shkencore.

Plani hulumtues është në përputhje me strategjinë hulumtuese në nivel universiteti. Në këtë rast duhet të theksohet se shpenzimet për shkencë dhe hulumtime janë në nivelin e vetëm prej 0,1 % e GDP.

Bazuar në disa të dhëna zyrtare, koeficienti i investimeve në shkencë dhe hulumtime në disa vende EEC është shumë më e lartë se në Kosovë.

Ca aktivitete të organizuara në hulumtimet shkencore nuk janë të përcjella në Universitet por këto aktivitete suportohen në baza individuale.

FE ka përcaktuar objektivat e hulumtimit shkencor të cilat janë të ndërlidhura me planin e zhvillimit të hulumtimit dhe në harmoni me objektivat e vendosura nga MASHT.

Burimet financiare janë të limituara ndërsa burimet njerzore dhe logjistike janë të mjaftueshme. UMIB-i, në përgjithësi si Universiteti i ri si dhe FE në veçanti është në fazën e zgjerimit dhe forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar me partner të ri dhe egzistues, të cilat në fokus kanë studentin, mobilitetin e stafit si dhe hulumtimin shkencor. Ne kemi vërejtur se në një mënyrë e arritjes së kësaj është përmes krijimit të njësive interdisiplinare, të cilat janë të identifikuar si qendra, institute, programe, laboratore ose të njëgjajshme.

Në përgjithësi këtyre u referohemi si "Njësi organizative hulumtuese" (NjOH). Përmes këtyre iniciativave ne jemi duke u përpjekur që të vendosim një bashkëpunim të qëndrueshëm brenda institucionit tonë por edhe mes institucionit tonë dhe IAL tjera.



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

Kjo na mundëson që të fokusohemi në fushat hulumtuese të shkencës, teknologjise, ekonomise, , duke kombinuar praktikat me te mira, duke rritur zotimin e mësimdhënësve brenda departamentit si dhe duke ofruar mundësit për ta, që të krijohen rrjete të komunikimit dhe bashkëpunimit.

Pritshmëritë për përfshirjen e stafit akademik në veprimtaritë kërkimore dhe akademike janë specifikuar qartë , dhe performanca lidhur me këto pritshmëri është marrë parasysh në kriteret e vlerësimit dhe promovimit të stafit.

Kriteret bazë për promovimin dhe avancimin e stafit mësimdhënës në lidhje me përfshirjen e personelit mësimor në veprimtaritë kërkimore dhe akademike përcaktohen nga UMIB dhe janë në përputhje me rregulloret e MASHT.

Bazuar në statutin e UMIB dhe rregulloren e promovimit është përcaktuar qartë se sa publikime duhet të ketë të publikuara secili mësimdhënës, që të promovohet në gradë akademike.

Kërkesat për pranimin e punës kërkimore për promovim të mëtejshëm janë si më poshtë:

Autori i parë në botimet e botuara në revistat ndërkombëtare sipas neneve 155, 156 dhe 157 të Statutit të UMIB. Në përputhje me Statutin e UMIB, punimi i botuar në revistat ndërkombëtare dhe shkencore është e vlefshëm për emërimin, riemërimin dhe avancimin e autorit të parë të veprës hulumtuese. Në bazë të statutit të UMIB dhe akteve të tjera ligjore në fuqi: Për Prof. Dr, kandidati i rregullt duhet të ketë së paku 5 punime (ose 5 pikë) për thirrjen Prof, të asocuar me të paktën 3 punime ,ndërsa për Profesor Asistent të paktën 1 të botuar në revistat shkencore ndërkombëtare konform UA-MASHT dhe rregullores për avansimet të UMIB-it.. Gjatë vlerësimit të kandidatëve të paraqitur në konkurs, punimet duhet të specifikohen në fushën e kandidatit, në revista të cilat janë të indeksuara në platformat përkatëse akademike.

Fakulteti Ekonomik në Universitetin "Isa Boletini" me Programet e studimit ka organizuar tryezë të rrumbullakët me temë: "Institucionet e arsimit të lartë konform kërkesave të tregut rajonal dhe atij ndërkombëtar të punës".

Organizimi i konferencave shkencore, simpoziume, tryeza të rrumbullakëta, punëtorive bëhet në bashkëpunim me nivelin e lartë të menaxhmentit të UMIB-it.

Fakulteti Ekonomik, së shpejti do të organizon konferencë shkencore, ku pjesëmarrës do të jenë stafi mësimdhënës, hulumtuesit, studentët, alumnit dhe bizneset. Publikimet e dalura nga këto konferenca shkencore do te procedohen me ISBN, në raportet shkencore të ISSN-së ose në revista të dedikuara për atë aktivitet të caktuar shkencor.

Në kuadër të Fakultetit të Ekonomisë ekziston një frymë bashkëpunimi dhe kolegialiteti në mbështetje të stafit, në veçanti të stafit më të ri, në zhvillimin e planeve kërkimore me mekanizma të ndryshëm si mentorimi, këshillimi profesional, përfshirja në ekipet e projektit, përzgjedhja e teknikave të hulumtimit, modeleve të hulumtimit etj. Profesorët me orar të plotë që posedojnë përvojë në aktivitetet kërkimore shkencore shpesh shërbejnë si udhëzues dhe mbështetës të stafit me eksperiencë të vogël kërkimore shkencore.

Kjo është konfirmuar nga fakti se shumë nga punimet shkencore të publikuara nga asistentët apo stafi tjetër akademik me përvojë të pamjaftueshme kërkimore shkencore janë botuar në bashkëpunim me profesorë me përvojë që shërbejnë si autorë korrespondues (<http://umib.net/wp-content/uploads/2018/11/Lista-e-publikimeve-t%C3%AB-stafit-Fakultetit-Ekonomik-2015-2018.pdf>).



2.4 Krijimi i komunitetit ALUMNI

Fakulteti do të krijoj një bazë të të dhënave për të përcjellur të arriturat e studentëve që diplomojnë. Kjo bazë e të dhënave do të freskohet me të dhëna afat të rregullt të diplomimit. Të dhënat e studentëve të Fakultetit Ekonomik do të transferohen në të dhënat në databazën ALUMNI në nivel qëndror.

2.5 Autonomia e Njesisë Akademike FE

Fakulteti Ekonomik gëzon autonominë dhe lirinë e mësimdhënies akademike, të kërkimeve shkencore si dhe të krijimtarisë artistike brenda veprimtarisë së tij. Mjediset e universitetit gëzojnë të drejtën e paprekshmërisë nga organet e rendit publik, përveç rasteve të përcaktuara ndryshe me ligje të veçanta.

Personeli arsimor dhe studentët e Fakultetit Ekonomik gëzojnë lirinë e bashkimit dhe të shprehjes brenda strukturave të parapara me nenin 9 dhe 10 të Statutit të përkohshëm të UMIB-it.

Pra njesisë Akademike të FE i është garantuar liria e krijimtarisë arsimore dhe shkencore, e cila përfshin të drejtën e stafit akademik dhe studentëve që të shqyrtojnë në mënyrë kritike njohuritë e fituara, të ofrojnë ide të reja dhe opinione të diskutueshme pa u ekspozuar nga ndonjë hakmarrje dhe të drejtën e lirisë së fjalës e që mund të kufizohet me ligj dhe me Statutin dhe rregulloret e UMIB-it është i pavarur në realizimin e aktiviteteve të veta dhe hapësirat e tij janë të pacenueshme në përputhje me ligjin dhe aktet normative në fjalë.

Personeli akademik është përgjegjës për mësimdhënien dhe mësimin, duke përfshirë punën kërkimore shkencore, angazhimin për konsultime studentore dhe përgjegjësitë e tjera që lidhen me kontratën e tij / saj.

Angazhimet e stafit të rregullt akademik rregullohen nga politika e UMIB dhe njësive akademike si ne vijim:

- Nga 6 mësimet në javë
- Nga 2-6 orë në javë, është e obligueshme që të mbahen konsultime me nxënësin
- Vlerësimi i Studentëve
- Mentorimi i diplomës së studentit
- Aktivitetet kërkimore
- Pjesëmarrja në strukturën e Universitetit në përgjithësi dhe në njësinë akademike, në veçanti si: anëtar i komisioneve, anëtar i senatit, shefi i programit, koordinatori i cilësisë, anëtar i këshillit të fakultetit
- Aplikimi për Grante në veçanti për Erasmus +
- Kontributi në komunitet në formën e ekspertizës

2.6 Mbrojtja nga diskriminimi



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

FE nuk do të lejojë të diskriminohet në aspektin e të drejtave të njeriut asnjë person mbi bazën racore, fetare, origjinës kombëtare ose etnike, moshës (pas moshës madhore), gjinisë, orientimit seksual, gjendjes martesore apo prindërore, aftësisë së kufizuar ose ndonjë paaftësie fizike, statusit civil dhe shtetësisë, burimit të ardhurave dhe statusit material, në veçanti në të drejtën për t'u regjistruar në FE, të drejtën për të studiuar dhe të drejtën për arsimim, kushtet për studimin dhe vlerësimin e arritjeve në mësimnxënie, trajtimin dhe angazhimin në FE.

Mbrojtja nga diskriminimi nga paragrafi paraprak vlen dhe zbatohet edhe për stafin e njësisë akademike FE të punësuar në Universitet.

3 VIZIONI DHE MISIONI I FAKULTETIT EKONOMIK

Vizioni dhe Misioni i Njësisë akademike e FE funksionon konform Vizionit dhe Misionit të UMIB-it

3.1 Vizioni i FE

Vizioni i FE është që të jetë Institucion prijës i Arsimit të Lartë dhe kërkimeve shkencore në Republikën e Kosovës, i fokusuar në përgatitjen e burimeve njerëzore për nevojat aktuale të ekonomisë.

3.2 Misioni i FE

Misioni i FE është që studenteve të vendit dhe regjionit tu krijojë mundësi studimi, hulumtimi dhe analizimi lidhur me dukuritë ekonomike konform kërkesave aktuale të tregut të punës.

Fakulteti Ekonomik përmes rishikimit dhe zgjerimit të programeve arsimore, kërkimore si dhe ndërmarrëse të arrijë nivelet më të larta të arsimit të lartë në regjion përmes përgatitjes së menaxherëve, ndërmarrësve, inovatorëve, ekonomistëve, kontabilistëve, financierëve kompetent për t'iu përgjigjur nevojave të shoqërisë dhe tregut të punës.

Misioni i programit të studimit është në përputhje me deklaratën e përgjithshme të misionit të UMIB-it, bazuar në planin strategjik trevjeçar dhe me misionin e FE si dhe akterëve tjerë nga industria.

Kjo do të arrihet duke:

- Nxjerre të diplomuar me njohuri bazike rreth veglave (tools) dhe teorive bazike për ekonomine.
- Nxjerre të diplomuar me aftësi për të menduarit kritik rreth problemeve ekonomike me të cilat ballafaqohet shoqëria dhe zgjidhjeve potenciale për këto probleme
- Nxjerre të diplomuar që kanë shkathtësi të duhura për të punësuar në sektoret ekonomik privat, shtetëror si dhe konform kërkesave të tregut të punës
- Nxjerre student të përgatitur për të vazhduar studimet e mëtejme në fushën e ekonomisë, menaxhmentit, biznesit, marketingut, ndërmarrësive dhe inovacioneve, financës, dhe të drejtës biznesore.



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

- Nxjerre studente te afte per te kryer hulumtime profesionale si dhe hulumtime shkencore ne bashkepunim me stafin akademik
- Fakulteti Ekonomik është i angazhuar për të siguruar programe arsimore dhe kërkimore në dobi të studentëve, shkencës dhe shoqërisë në përgjithësi.
- Realizimi i objektivave të më sipërme do të mundësoi diferencimin studentëve të Fakultetit Ekonomik nga studentët e universiteteve tjera konkurente. Organizimi i studimeve sipas standardeve evropiane të shkollimit të lartë si dhe kërkimeve shkencore dhe profesionale duke kombinuar teorinë dhe praktikën për pjesëmarrje aktive në ekonomitë lokale, regjionale dhe globale, do t'i kontribuojë zhvillimit të gjithëmbarshtëm regjional si parakusht për barazimin me pjesën e zhvilluar të Evropës

Tabela 4: Analiza SWOT për misionin, objektivat dhe administratën:

A. Pikat e forta	B. Dobësitë
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Misioni i FE në kuadër të Universitetit Isa Boletini, qartë I definuar dhe i orientuar nga profilizimi i studimeve në fushën e Biznesit dhe Menaxhmentit, ▪ Specializimet ne kuader te programit jane konform me kerkesat e tregut te punes ▪ Mesimdhenia bazohet ne konceptet e definuara qarte didaktike dhe hulumtuese ▪ Ofrimi i njohurive bashkëkohore dhe interaktive në përgatitjen e studentëve në fushat e biznesit dhe menaxhmentit krahas kerkesave te tregut, ▪ Fakulteti ekonomik në programin e ofruar studimor ka bërë diferencimin nga Universitetet tjera. ▪ Posedimi rregulloreve te brendshme per funksionim konkret ne kuader te njesise 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mundesia e kufizuar per praktiken profesionale me pagese per studentet ne Institucionet te ndryshme, ▪ Mungesa e literaturës sipas kurikulave të reja në gjuhën shqipe; ▪ Mungesa e akreditimit për dy vite radhazi e ka dëmtu në një masë imazhin e fakultetit. ▪ Operational structure/bureaucracy ▪ Struktura operacionale / burokracia ▪
C. Mundësitë	D. Sfidat
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mundesite e reja per bashkepunim me industrine dhe Institucionet shteterore ne aspekt te avansimit te bashkepunimit permes punetorive, seminareve, praktikes profesionale etj. ▪ Interest in academic program expansion (Interesimi per zgjerimin e programeve te reja) 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Buxheti I limituar I qeverise ▪ Development of similar study programmes in the area ▪ Societal and student perception of education as solely a means to a job



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

- | | |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none">▪ Increase demand for mid-career redirection and life long learning▪ Ritja e kërkeses për avancimin e karrieres dhe të mesuarit gjatë gjithë jetes | |
|---|--|

3.3 Udhëheqja, menaxhimi dhe marrëveshjet e administratës dhe personelit

Njësia akademike e FE funksionon sipas statutit të UMIB-i dhe ka strukturë organizative, funksionale dhe efikase.

4 PËRMBLEDHJA E STRATEGJIVE KRYESORE DHE INICIATIVAT STRATEGJIKE

FE në përputhje me misionin dhe vizionin e përcaktuar, si dhe qëllimet e punës është i orientuar dhe i vendosur që në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike të zhvillojë strategjinë e vet, të monitorojë dhe përmirësojë sistemin e menaxhimit të cilësisë, për periudhën kohore 2018-2021.

FE, sipas të gjithë treguesve përkatës, është universiteti i njohur me qëllimet e tij për zhvillimin e kërkimeve të tij shkencore në fushën e lëmvive ekonomike dhe atyre edukative.

Bazuar në këto fakte mund të konkludojmë se si i tillë njëherit paraqet potencial të madh për zhvillimin ekonomik të vendit.

Në vlerësojmë se FE ka nevojë për të investuar në zonat e shërbimit bazë, për të mbetur konkurrues në afat të shkurtër dhe kemi identifikuar një sërë përparësish për këto investime të menjëhershme. Marrja me këto prioritete është domosdoshmëri, në qoftë se Universiteti do ta ruajë udhëheqjen e duhur për t'u bërë një prani globale.

Kështu që FE duhet të bëjnë përpjekje të mëtutjeshme shtesë për të kontribuar për të krijuar një ambient hulumtimi më të mirë dhe më stimulues për gjeneratat e reja që studjojnë në FE.

4.1 Objektivat dhe qëllimet e përgjithshme të zhvillimit të FE

Objektivat dhe qëllimet e përgjithshme të zhvillimit të FE është në harmoni me objektivat dhe qëllimet e përgjithshme të zhvillimit të UMIB-i si më poshtë:

- Edukimi i studentëve në universitet të bazohet në përvojat dhe traditat më të mira në rajon , universiteteve evropiane, botërore dhe zbatimit të të gjitha parimeve të reformës të iniciuara nga Procesi i Bolonjës i Reformës Evropiane të Arsimit të Lartë;
- Ngritja dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të ofruara arsimore për të rritur reputacionin e Universitetit tek studentët tanë dhe në publik;
- Sigurimi i shërbimeve arsimore dhe shkencore të mësimdhënies në përputhje me kërkesat , pritjet dhe me mundësitë e studentëve tanë dhe shoqërisë në tërësi;



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

- Të sigurojë përputhjen e punës së Universitetit me rregullat ligjore, aktivitetet dhe të sigurisë së punës të Universitetit;
- Sigurimi i një mjedisi të sigurt dhe të shëndosh për të gjithë të punësuarit;
- Përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve, sistemeve dhe aftësive të punës ;
- Nxitja e Ekselencës Kërkimore;
- Të mësuarit për një botë me diversitet;
- Globalizimi dhe ndërkombëtarizimi i programeve akademike.
- Qëllimet e zhvillimit janë krijuar në të gjitha funksionet relevante dhe nivelet brenda Universitetit. Universiteti me qëllim të përmbushjes së misionit të tij vazhdimisht monitoron,
- analizon dhe përmirëson proceset e tij përmes:
- Analiza e reagimeve nga palët e tjera ;
- Monitorimin e realizimit të procesit mësimor;
- Analiza e suksesit të studimit;
- Monitorimin e zbatimit të procesit të shërbimit;
- Aplikimi i metodave dhe teknikave për përmirësimin e cilësisë;
- Monitorimin dhe analizimin e planit të biznesit;
- Implementimi i auditimeve të brendshme;
- Ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese dhe preventivat -parandaluese.

5 FUSHAT STRATEGJIKE DHE INICIATIVAT STRATEGJIKE

5.1 Mësimdhënia, Mësimënxënia kërkimi dhe shërbimi

FE është i përkushtuar për cilësi në mësimdhënie duke u fokusuar në pikat si më poshtë :

- Trajnimi i stafit në metodat e mësimdhënies në përshtatje të lëndës dhe nevojave të studentëve;
- Përmirësimi i mësimdhënies duke përdorur metodologji të reja;
- Sigurimi i zhvillimit të stafit akademik në pedagogji;
- Nxitur kërkimin shkencor tek mësimdhënësit dhe studentët, duke ofruar praktikë mësimore krahas teorisë;
- Krijimi i praktikës për Shërbim të Komunitetit nga stafi akademik.

Rezultatet e synuara të mësimimit janë në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe Kornizën për Kualifikimet e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë.

Rezultatet mësimimit që synohen të arrihen janë në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe Kornizën për Kualifikimet e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë sepse këtu merren parasysh:

Rezultatet e mësimimit që duhet të arrihen janë në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe Kornizën e Kualifikimeve të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë, sepse merren parasysh:



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

- Analiza e tregut të punës vendor dhe rajonal arrihet përmes raporteve statistikore, kontakteve me partnerë nga industria.
- Diskutimeve në këshillin e fakultetit ku dhe merret iniciativa
- Konsulenca me ekspert përkatës të fushës nga institucionet tjera akademike
- Krahasimin me programet e tjera nderkombetare gjithnjë duke ju pershtatur nevojave të tregut vendor dhe rajonal
- Involvimi i paleve të treta (me kompani private, publike, sektorin bankar, institute etj.), ku edhe nënshkruhen memorandumet e bashkëpunimit përmes kontakteve të vazhdueshme informuese dhe punës praktike si pjesë e procesit të arritjes së rezultateve të synuara

Rezultatet e synuara të mësimit janë në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe Kornizën për Kualifikimet e Zonës Europiane të Arsimit të Lartë.

Rezultatet e mësimit që synohen të arrihen janë në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe Kornizën për Kualifikimet e Zonës Europiane të Arsimit të Lartë sepse këtu merren parasysh:

Rezultatet e mësimit që duhet të arrihen janë në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe Kornizën e Kualifikimeve të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë, sepse merren parasysh:

- Analiza e tregut të punës vendor dhe rajonal arrihet përmes raporteve statistikore, kontakteve me partnerë nga industria.
- Diskutimeve në këshillin e fakultetit ku dhe merret iniciativa
- Konsulenca me ekspert përkatës të fushës nga institucionet tjera akademike
- Krahasimin me programet e tjera nderkombetare gjithnjë duke ju pershtatur nevojave të tregut vendor dhe rajonal
- Involvimi i paleve të treta (me kompani private, publike, sektorin bankar, institute etj.), ku edhe nënshkruhen memorandumet e bashkëpunimit përmes kontakteve të vazhdueshme informuese dhe punës praktike si pjesë e procesit të arritjes së rezultateve të synuara

Objektivat mesimorë të studentëve:

- **Objektivi 1:** Të kuptojë procesin e biznesit dhe menaxhimit sipas studimit në specializimet që ofron programi i FE.
- **Objektivi 2:** Të bëhet kompetent në menaxhimin situatave që ofron tregu i punës, me synimin përfundimtar të optimizimit të procesit të vendimmarrjes.
- **Objektivi 3:** Të bëhet kompetent në realizimin me sukses të zgjidhjeve nga teoria në praktikë që kanë të bëjnë me implementim e dijes së fituar gjatë studimit, etj.
- **Objektivi 4:** Programi i studimeve të ciklit të parë Bachelor (Bsc) ofrohet në përputhje me nevojat e tregut të punës.

Fakulteti Ekonomik është i angazhuar për të siguruar programe arsimore dhe kërkimore në dobi të studentëve, shkencës dhe shoqërisë në përgjithësi.

Pas përfundimit të studimeve studenti duhet të jete në gjendje të :

- Be able to identify economic issues and problems, gather data needed to evaluate them, and analyze the data to gain insights into economic behavior and formulate possible solutions.
- Të ndërtojë opinione të qëndrueshme lidhur me fenomenet dhe praktikat biznesore dhe menaxheriale,



- të argumentojë opinionet e tij dhe të tjerëve në fushat përkatëse

Realizimi i objektivave të më sipërme do të mundësoi diferencimin studentëve të Fakultetit Ekonomik nga studentët e universiteteve tjera konkurente. Organizimi i studimeve sipas standardeve evropiane të shkollimit të lartë si dhe kërkimeve shkencore dhe profesionale duke kombinuar teorinë dhe praktikën për pjesëmarrje aktive në ekonominë lokale, regjionale dhe globale, do t'i kontribuojë zhvillimit të gjithëmbarshtëm regional si parakusht për barazimin me pjesën e zhvilluar të Evropës.

5.2 Burimet e mësimit dhe mbështetja e studentëve

FE do të sigurojë burime të mjaftueshme adekuatë dhe bashkëkohore për mësim, të cilat do të jenë në dispozicion të studentëve në të gjitha programet e studimit.

- Ofrimi i shërbimeve në lehtësim të procesit të mësim nxënies dhe realizimit të detyrave Studentore;
- Sigurimi i komunikimit të vazhdueshëm student-mësimdhënës për arritjen e rezultateve më të mira të mësim nxënies;
- Nxitja e studentëve të jenë pjesë aktive e të nxënit dhe të jenë faktor në ndryshimet e nevojshme të proceseve brenda UMIB-it;
- Organizimi i punëtorive tematike të studentëve me qëllim të lidhjes së aktiviteteve mësimore, profesionale dhe shkencore të Universitetit;
- Lidhja në mes aktiviteteve edukative, shkencore dhe kërkimore, si dhe aktiviteteve publike
- sigurimi i kushteve për studentët me nevoja të veçanta për qasje sa më të lehtë në kampus dhe në marrjen e shërbimeve nga UMIB-i;
- Zhvillimi i shoqatës Alumni të ish studentëve të universitetit, me qëllim të promovimit të reputacionit të Universitetit në vendin tonë dhe në botë.

5.3 Sigurimi i cilësisë

Në Fakultetin Ekonomik, sigurimi i cilësisë bazohet në:

- Udhërrëfyesin për Sigurimin e Cilësisë së UMIB, i aprovuar nga Senati i UMIB-it, në pajtueshmëri edhe me Statutin e tij.
- Në rregulloret e brendshme të Fakultetit Ekonomik që do të miratohen nga Këshilli Mësimor-Shkencor,
- Udhërrëfyesin sipas Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë

Synimi i zhvillimit të sistemit të sigurimit të cilësisë në Fakultetin Ekonomik përfshinë hartimin e politikave, procedurave, kulturës për sigurimin e cilësisë, duke e krahasuar me standardet në nivel të UMIB.



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

Në FE, synim i veçantë në sigurimin e cilësisë është sistemi i vetëvlerësimit, mbikqyrjes dhe akreditimit, dhe e gjitha kjo duke respektuar autonominë. Sistemi i sigurimit të cilësisë dhe vlerësimi periodik fokusohen në:

- - Menaxhim;
- - Organizim
- - Politikat e qendrueshme për rekrutimin e stafit;
- - Procesin e mësim;
- - Rritjen e mobiliteteve të pedagogëve dhe studentëve;
- - Prezantimin dhe zbatimin e ECTS, skemën e akreditimit, zhvillimit të kurrikulës, metodat e reja të mësim-nxënjes dhe mentorimit
- - Procesin e kërkimit dhe hulumtimit shkencor.

Permiresimi i vazhdueshëm i performances qe ka dal nga proceset e sigurimit te cilesise është bërë përmes:

- Harmonizimit të syllabuseve
- Permbajtjes së lendeve
- Rregullimit të ECTS-ve
- Përmiresimit të performances se stafit varesisht nga rekomandimet e raporteve te vleresimit
- Rritja e vijueshmerise se studenteve
- Permiresimi i paisjeve teknike dhe infrastruktures
- Permiresimi i sistemit te dhenave te studenteve (SMU)
- Ngritja e zbatueshmerise se metodave interaktive nga ana e mesimdhenesve

Proceset e sigurimit të cilësisë paraqesin një pasqyrë të performancës së arritur dhe tregojnë se standardet e sigurimit të cilësisë janë përmbushur si dhe mundësojnë detektimin e fushave për përmirësim të cilat ndikojnë në ngritjen e vazhdueshme të performancës. Me këtë rast rishikohen:

- Përmbytja e programit në dritën e hulumtimit më të fundit në disiplinën e dhënë, duke siguruar kështu që programi është i përditësuar;
- Ngarkesën mësimore, progresin dhe kompletimin e studentëve me dije;
- Efektshmërinë e procedurave të vlerësimit për studentët;
- Pritshmëritë, nevojat dhe kënaqshmërinë e studentëve në lidhje me programin e realizuar;

Programet vlerësohen dhe rishqyrtohen rregullisht duke i përfshirë studentët dhe palët e interesuara nga bizneset. Informacioni i mbledhur analizohet dhe programi përshtatet për të garantuar që ai është i përditësuar, i realizueshëm për tregun e punës. Specifikimet e programit të rishikuar publikohen në web faqen e FE.

Tabela 5: Analiza SWOT për sigurimin e cilësisë:

<i>E. Pikat e forta</i>	<i>F. Dobësitë</i>
-------------------------	--------------------



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

<ul style="list-style-type: none">• Avancimi i sistemit te menaxhimit të universitetit (SMU)• Plani strategjik• Themelimi i asociacionit ALUMNI si menyre e marrjes se komenteve per permiresim nga studentet e diplomuar• Infrastruktura e mjaftueshme dhe e pershtatshme për procesin mesimor• Përfaqësim i mirë i studentëve në kuadër të menaxhimi i universitetit ne te gjitha strukturat (Senati, Këshillin e FE)• Numer i mjaftueshem i studentëve dhe kërkesa progressive për studime kontempore (p.sh biznes dhe menaxhment)	<ul style="list-style-type: none">• Ambientimi me infrastrukturën konsumon energjinë e stafit akademik por edhe atij administrativ• Mungesa e qasjes në libraritë dhe databazat elektronike pamundëson ndjekjen trendeve bashkëkohore studimore dhe hulumtuese.
--	--



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

A. Mundësitë	B. Sfidat
<p>Proceset integruese në të cilat është përfshirë vendi ynë, krijojnë mundësi të mëdha për zgjerimin e bashkëpunimit të Fakultetit Ekonomik me institucione brenda rajonit dhe më gjerë, në fushën e mësimdhënies e kërkimit shkencor.</p> <p>Tendenca në rritje e besimit të publikut ndaj cilësisë të arsimit të lartë përbën një mundësi për zhvillimin e mëtejshëm të Fakultetit Ekonomik.</p> <p>Fryma aktuale përgjithësisht konstruktive midis institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë në vend, përbën një mundësi për shkëmbim eksperience, ekspertize, informacioni, dijesh, teknologjish dhe burimesh njerëzore, por njëkohësisht ajo shërben edhe si një mundësi për reflektim e përmirësim të vazhdueshëm.</p> <p>Stabiliteti i vazhdueshëm i vendit tonë, në të gjitha aspektet, shton mundësinë e kthimit gjithnjë e më të madh të "trurit", duke krijuar mundësi për përzgjedhje të akademikëve dhe shkencëtarëve më të mirë dhe të atyre me perspektivë.</p>	<p>Domosdoshmëria për diversifikimin e burimeve të financimit dhe mosmarrja e veprimeve konkrete në këtë drejtim, mbart rrezik për FE si institucion i vetëfinancuar në tregun kosovarë.</p> <p>Mosndjekja e tregut të punës dhe e tendencës së zhvillimit të arsimit të lartë në Kosovë, rajon e më gjerë, dhe mosreflektimi i ndryshimeve në filozofinë, strategjinë, menaxhimin e institucionit, kurrikulat, programet e lëndëve, dhe gjithë dokumentacionin ku mbështetet veprimtaria e FE, rrezikon të vendosë në vështirësi rritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të FE.</p> <p>Moskordinimi në nivel të duhur ndërmjet MASHT, MTI-së, dhe MPMS në aspektin e hartimit të strategjive lidhur me nevojat e tregut të punës krijon konfuzion në orientimin e karrierës së studentëve pas diplomimit.</p> <p>Ndryshimet e shpeshta të politikave ekonomike të vendit dhe kërkesave të tregut të punës mund të ndikojnë negativisht në veprimtarinë e FE.</p>



Tabela 6: Vlerësimi sipas treguesve matës të sigurimit të cilësisë në kuadër të FE

Nr	Anëtarët e njësisë së mbrendëshme për sigurimin e cilësisë – FE Members of the internal quality assurance unit - FE	Detyrat që kanë anëtarët e njësisë së mbrendëshme për sigurimin e cilësisë – FE The members asks of the members of the internal quality assurance unit - FE
1	Kordinator i cilësisë FE	Detyrat: Raporton Dekanit dhe Komisionit të Cilësisë të Rektoratit. Përgjegjësitë: Përgjegjësitë e tyre përfshijnë dorëzimin e anketimeve / pyetësorëve anonimë tek studentët, procesimin e përgjigjeve / të dhënave të tyre dhe përgatitjen e raporteve përkatëse për çdo lëndë në një platformë elektronike. Raporton mbi baza kuartile ne dekanat ne lidhje me aktivitetet e programit si dhe paraqet planfikimin per vitin e ardhshem akademik. Permbledhja e ketyre raporteve kuartile nga dekanati percjellet ne rektorat ne baza vjetore.

5.4 Regjistrimi i studentëve në FE

Studentët e regjistruar në programin e studimeve posedojnë një diplomë të diplomës së shkollës së mesme ose një dokument tjetër ekuivalent studimi, sipas kërkesave të MASHT-it. Ekziston një procedurë e pranueshme e pranuar zyrtarisht në nivel institucional që programi i studimit respekton gjatë organizimit të rekrutimit të studentëve në nivel të UMIB-it dhe në nivel njësie për procedura që kanë të bëjnë me çështje konkrete procedurale dhe akademike. Kërkesat për pranim aplikohen në mënyrë të vazhdueshme dhe të drejtë për të gjithë studentët me rastin e regjistrimit të studentëve kritere të cilat duhet përmbushur dhe të cilat janë në harmoni të plotë me Udhzimet e MASHT-it.

5.5 Zhvillimi i burimeve njerëzore

Zhvillimi i burimeve njerëzore të FE është në harmoni me objektivat dhe qëllimet e përgjithëshme të zhvillimit të UMIB-i si më poshtë:

- Fillimisht personeli akademik i FE është angazhuar nga UMIB-i, në marrëdhënie të rregullt pune dhe UP në marrëdhënie sekondare të punës në bazë të marrveshies në mes të këtyre dy instuticioneve. Në vitin akademik 2016-17 në Fakultetin Ekonomik kemi



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

përzgjedhur edhe 5 mësimdhënës të rregullt dhe asistentë të rregullt që janë paraqitur në tabelën në vijim sipas thirrjes së tyre akademike dhe shkencore.

- Tashmë me kontratë të rregullt pune i kemi gjashtë doktor shkencash nga lëmi i ekonomisë dhe atë: një Prof Dr, dhe pesë Prof Ass Dr. Është me rëndësi të ceket fakti se shumica profesorëve dhe asistentëve dhe disa ligjërues kanë fituar titujt shkencor në Universitete të njohura evropiane duke ndikuar dukshëm në qasjen dhe cilësinë e mësimdhënies dhe të aktivitetit shkencor në Fakultetin Ekonomik.
- Zhvillimi i organogramit të personelit dhe strukturave të ardhshme të stafit FE;
- Rritja e trajnimit të stafit administrativ FE;

5.6 Zhvillimi i sistemit për informim publik

FE ka për detyrë ta informojë UMIB-in për arritjet në FE përmes koeficienteve sasiorë dhe cilësorë, mbi punën dhe rezultatet e punës, si dhe të jetë në dispozicion për të gjitha palët e interesuara.

FE i kushton vëmendje të veçantë komunikimit me palët e interesuara duke ndërmarrë veprime të tilla si:

- Promovimi i Fakultetit Ekonomik në tregun e punës (publik);
- Rritja e imazhit të FE nëpërmjet zhvillimit të "marketingut të ngjarjeve" dhe "marketingut të veprimeve";
- Implementimi i sistemit informativ globalisht konkurrues;
- Informimi i të gjitha subjekteve të Universitetit;
- Trajnimi i punonjësve për rëndësinë e komunikimit efektiv.

5.7 Globalizimi / Ndërkombëtarizimi

FE gjithnjë inkurajon bashkëpunim më intensiv ndërkombëtar në fushën e mësimdhënies dhe punës kërkimore si parakusht për përfshirjen e Fakultetit Ekonomik në projektet shkencore dhe kërkimore evropiane dhe arsimore.

- Rritja e partneriteteve globale në fushën ekonomike dhe inovative;
- Rritjen e mobilitetit të stafit dhe studenteve (Internship, vazhdim studimesh etj.);
- Rritja e numrit të aplikimeve për bursa (Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar);
- Rritja e aplikacioneve të projekteve të përbashkëta për programe të doktoratave dhe marrjen e fondeve ndërkombëtare;
- Baza e të dhënave elektronike për menaxhimin e donacioneve dhe projekteve Ndërkombëtare;
- Rritja e efikasitetit të verifikimit të transkriptove dhe dokumenteve (sipas kërkesës së partnerëve ndërkombëtarë);
- Rritja e bashkëpunimit me publikun ndërkombëtar jo universitar apo korporatat private dhe avancimin e bashkëpunimit në projekte të përbashkëta;
- Organizimin e konferencave dhe aktiviteteve të përbashkëta me partnerët relevant.



6 MONITORIMI, VLERËSIMI, DHE RAPORTIMI

Monitorimi dhe vlerësimi janë faktorë themelorë të zbatimit të një strategjie të mirëfilltë dhe synojnë matjen e progresit të arritur. FE do të krijojë Grupin për Koordinimin dhe Monitorimin e Zbatimit të Planit Strategjik i cili drejtohet nga një Koordinator i emëruar nga stafi menaxhues FE dhe në përbërje të të cilit do të jenë Dekani, Prodekani dhe Shefi i departamentit FE dhe përfaqësues në kuadër të Rektoratit.

Detyrat kryesore të këtij trupi janë:

- Hartimi i planeve të arriturave 6 mujore të veprimit në përputhje me PSFE
- Analiza e progresit në zbatimin e PSUMIB , në bazë të informatave të mbledhura
- Hartimi i buxhetit vjetor për zbatimin e PSUMIB në kuadër të kufijve buxhetorë të përcaktuar;
- Shqyrtimi dhe miratimi i masave plotësuese për të siguruar zbatimin e PSUMIB ;
- Hartimi i kërkesave për mbështetje nga programet e donatorëve me qëllim të sigurimit të zbatimit të PSFE .

Monitorimi dhe vlerësimi i qëndrueshëm i kësaj strategjie e bën Planin e Veprimit të jetësohet dhe u siguron zbatuesve të saj një pasqyrë e cila ua mundëson të veprojnë me kohë dhe në përputhje me nevojat dhe sfidat me të cilat përballen.

Në fund të zbatimit të strategjisë do të bëhet një vlerësim i përgjithshëm për të kontrolluar deri në çfarë mase kjo strategji ka ndikuar në forcimin e FE, që rezultatet, vështirësitë, ndikimi, qëndrueshmëria, mësimet e nxjerra dhe rekomandimet të shërbejnë për strategjitë në të ardhmen. Bazuar në rezultatet e këtij vlerësimi gjithëpërfshirës, FE do të jetë në gjendje t'i planifikojnë strategjitë e ardhshme.

Veprimet dhe aktivitet që do të ndërmerren për implementimin e këtij dokumenti do të mundësojnë vazhdimin e zhvillimit të FE me programet e reja dhe rolin e tij, me një qëllim të caktuar që të njihet në nivel kombëtar dhe atë ndërkombëtar për mësimdhënie të avancuar dhe edukim cilësor.

Ky PSFE do të ndihmojë në vazhdimin e mëtejshëm drejt ngritjes së cilësisë në mësimdhënie, mësimnxënie dhe zhvillimin e programeve mësimore në përputhje me nevojat e tregut të punës.



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

7 PËRFUNDIMI

Plani Strategjik i Fakultetit Ekonomik të UMIB-it, përmbanë pikat dhe objektivat minimale të vendosura për të garantuar qëndrueshmëri të programit dhe një zhvillim më të madh akademik.

Strategjia përfshinë orientimin drejtë përforsimit të standardeve aktuale mbi të cilat funksionon program i Fakultetit Ekonomik dhe avansimin tutje të këtyre standardeve. Vendosja e studentit në qendër dhe ofrimi i mundësive sa më të mëdha për ta paraqet tjetër parim mbi të cilin do të funksionoj kjo strategji. Fakulteti Juridik, do të kujdesët që të përmbushë në përpikmëri strategjinë me qëllim të ofrimit të një program sa më të kompletuar për studentët dhe mbetjes konkurent të denjë me institucionet tjera që ofrojnë edukim juridik.

Kjo strategji është miratuar për periudhën e ardhshme trevjeçare. FE është bindur që me implementimin e këtyre iniciativave në strukturat organizative përkatëse të FE do të ndryshojnë pozitivisht zhvillimet në FE në arritjen e qëllimeve të përbashkëta për një arsim sa më cilësor dhe për një punësim sa më të madh të të diplomuarve në FE, të cilëve nuk do t'u mungojnë njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat që sot i kërkon tregu i punës.

Prandaj, implementimi i këtij Plani Strategjik shtrohet si një obligim për të gjithë akterët e FE, për të punuar në përmbushjen dhe avancimin e misionit të FE dhe UMIB-i si dhe obligimeve që FE ka ndaj studentëve dhe qytetarëve të Kosovës për një arsim cilësor dhe me vlera.

Iniciativat strategjike janë prezantuar më poshtë në formë tabelore për t'u lexuar dhe ekzekutuar më lehtë. Njësitë administrative dhe akademike të FE pritët që të zhvillojnë plane për zbatimin e iniciativave, objektivave dhe detyrave/aktiviteteve brenda njësisë FE në harmoni me UMIB-it.



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

8 Shtojca

Në vazhdim do të paraqesim shtojcat e objektivave, qëllimeve, detyrave , aktiviteteve, afatet kohore dhe përgjegjësit e implementimit të planit strategjik konform Statutit dhe rregulloreve të UMIB-it.

1. Mësimdhënia, kërkimi & shërbimi				
Objektiva Strategjike	Qëllimi	Detyrat - Aktivitetet	Afatet kohore	Përgjegjësitë
Ndërveprimi me aktivitete mësimore.	Rrjedha e procesit mësimor, transferimi i njohurive, përvojës nga profesorët tek studentët mund të realizohet duke organizuar punëtori profesionale, si dhe prezantimet e projekteve profesionale të përbashkëta nga të dy palët si dhe nga punonjësit tjerë që mbështesin procesin mësimor në Universitet.	Organizimi i punëtorive profesionale me studentët profesorët si dhe nga punonjësit tjerë që mbështesin procesin mësimor në Universitet. Udhëheqësit e projek-teve profesionale paraqesin projektet e tyre, secila NJA brenda Fakultetit të paktën një punëtori gjatë vitit. Zhvillimi i bazës së të dhënave të projekteve profesionale, studimeve dhe ekspertizës. Arkivi të jetë vazhdimisht në dispozicion për punonjësit dhe studentët.	2019 - 2021	SA NJA ZSC PS
Rritja e mundësive për zhvillim profesional të stafit akademik.	Përforcimi i FE në aspektin e numrit të SA të kualifikuar dhe që SA të jetë më kompetentë në mësimdhënie dhe për vlerësime në komisione profesionale për thirrje akademike.	Harmonizimi dhe rritja e numrit të profesorëve në raport me numrin e studentëve, sipas buxhetit të UMIB-it. Dmth. Rritja e koeficientit të numrit të profesorëve / numrit të studentëve, sipas mundësive që i lejon buxheti i UMIB. Vlerësimi i performancës së profesorëve përmes një ankete të studentëve. Intensifikimi i punës së profesorit në botimin e teksteve shkollore dhe materialeve të tjera mësimore;	2019 - process i vazhdueshëm	



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

		Rritja e pjesëmarrjes së mjeteve elektronike në mësimdhënie.		
Të përmirësohen udhëzimet duke paraqitur metodologji të reja (p.sh. mësimi elektronik, të Mësuarit e aplikuar etj.) të sigurohet zhvillimi i trupit pedagogjik në pedagogji.	Përmirësim të njohurive të studentëve & zotërimi, rritja e të menduarit kritik, kalimi në metoda të reja të mësimdhënies larg formatit të igjëratave të thjeshta, evoluim në një sistem testimi formativ (P.sh. të bazuar në kompetencë, aktiv të aplikuar etj.)	Miratimi i një plani për publikimi online të materilalet të ligjëratave ; Të trajnohet i gjithë trupi pedagogjik në teknikat e reja të mësimdhënies dhe softuerit; Trajnimi i mësimdhënësve të FE në kuadër të zhvillimit profesional.	Janar 2019 - process i vazhdueshëm	SA NJA ZSC FE UMIB-i
Zbatimi i nismave të reformës në FE në harmoni me UMIB.	Kjo çështje është ngritur nga vetmotivimi dhe entuziazmi i stafit akademik që synojnë të zbatojn një numër masash me qëllim mbështetjes për rritjene cilësisë së mësimi.	FE bënë përpjekjet e saj për të zbatuar proceset e reformave evropiane dhe për ta bërë këtë përmirësim në harmonizim me strukturën e arsimit të lartë dhe kuadrin ligjor arsimor në përputhje me nevojat specifike të vendit, me qëllim të përmirësimit të efektivitetit dhe konsistencës së masave shoqëruese përmes një korniza për të forcuar kapacitetet institucionale, bashkëpunimin dhe zhvillimin. FE në periudhën e ardhshme duhet të bëjë çdo gjë të nevojshme për të optimizuar		



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

		proceset përmes kornizave ekzistuese ose të reja ligjore si dhe në bashkëpunimi të ngushtë me të gjithë faktorët relevant pjesëmarrës në këto procese, në mënyrë që këto institucione të arsimit të lartë të jenë konkurruese në tregun evropian të arsimit të lartë.		
Burimet e Mësimit dhe mbështetja e studentëve	FE do të sigurojë burime të mjaftueshme adekuate dhe bashkëkohore për mësim, të cilat do të jenë në dispozicion të studentëve në të gjitha programet e studimit. Përmirësimin e komunikimit të studentëve-profesor.	Rritja e fondit të bibliotekës me libra dhe revista profesionale; Rritja e pjesës të punës praktike dhe përmirësimi i pajimit të laboratoreve me pajisjeve laboratorike.	2019-process i vazhdueshëm	NJA FE UMIB-i MASHT-i
Krijimi i kriterve të përsosmërisë dhe relevancës.	Duke promovuar përsosmërinë dhe rëndësinë shkencore, qëllimi është, përveç botimit të një numri më të madh të hulumtimeve, të arrihet një nivel që do të mundësojë krijimin e njohurive të reja, zhvillimin teknologjive ekzistuese dhe përcaktimin e specializimeve shkencore të FE në bashkëpunim me UMIB-it. Përsosja shkencore dhe rëndësia do të vlerësohet sipas standardizimit ndërkombëtar.	Instrumentet për arritjen e këtij qëllimi janë: Krijimi i një modeli të ri të financimit të aktiviteteve të bazuara në ekselencën e tyre ; -Përzgjedhja e projekteve, përveç rishikimeve kompetente (duke përfshirë ndërkombëtare rishikimet), një sërë treguesish të performancës do të përdoren për t'u përdorur për vlerësim projekti. Modeli i financimit bazuar në financimin e projektit dhe institucional përmes: -Vlerësimi i shkallës dhe cilësisë së hulumtimit në aspektin e ekselencës; -Bashkëpunimi shkencor dhe ndërdisiplinor; - Bashkëpunimi me ekonominë dhe kulturën, dhe rëndësia sociale e hulumtimit.	Janar 2019 - vazhdim	SA NJA ZZHA UMIB-i



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

Mbështetje për hulumtuesit e rinj.	Programet që do të zhvillohen ekskluzivisht për hulumtuesit e rinj do të jenë në përputhje me praktikën dhe standardet evropiane për mbështetje të shkencëtarëve të rinj , të krijuar në bazën e barabartë të kornizës për arsimin e lartë në sektorin publik dhe privat .	Mbështetja dhe promovimi i shkencëtarëve të rinj është vlerë shtesë për zhvillimin e proceseve akademike-shkencore në institucionet e arsimit të lartë. të formohen kritere në bazë të të cilave do të mbështetet puna e hulumtuesve të rinj dhe në këtë mënyrë do të mundësohet krijimi i një rrjeti cilësor i hulumtuesve të rinj nga të gjitha fushat shkencore dhe duhet të inicohet iniciativa për të krijuar një hapësirë që do ta mundësojë studiuesve të rinj për të publikuar punën e tyre në platformat elektronike WEB.	2019 -2021	SA NJA ZSC PS
Ngritja e arritjeve të studentëve gjatë studimeve.	Ngritja e arritjeve të studentëve në të gjitha programet e studimit në drejtim të suksesit të rezultateve të studimit dhe të të nxënit.	Vlerësimi meritore i studentëve në bazë të kritereve dhe rregullave publike, adekuate dhe të qarta dhe me të cilat ata janë të njohur paraprakisht në të gjitha programet e studimit; Përputhshmëria e regjistrimit në një vit më të lartë të studimit të mbahen në intervalin deri në 50% nga viti paraprak; Rritja e suksesit të kalueshmërisë të studentëve nga studimet e ciklit të parë në studimet e ciklit të dytë deri në 25%; Shpërblimi i studentëve të dalluar gjatë vitit akademik. Shkurtimi i kohëzgjatjes mesatare të studimit krahasuar me periudhën e mëparshme për çdo program studimi;	2019 - process i vazhdueshëm	SA NJA ZSC PS



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

		Përqindje më të ulët të studentëve të ç'regjistruar dhe rritja e numrit të studentëve që kanë vazhduar studimet pasi që kanë humbur vitin paraprak Rritja e notës mesatare dhe numrit të studentëve të diplomuar.		
Satisfaksioni i studentëve.	Ngritja e satisfaksionit të përgjithshëm të studentëve.	Rritja e ofertës së aktiviteteve jashtë mësimore (rekreacion, forma informale të arsimit, kurse), të organizuara nga FE, shoqatat studentore, ligjërata për t'u mundësuar studentëve të përjetojnë përvojat botërore të situatave të jetës reale ("studim i rastit"), Ankesat dhe kërkesat e studentëve të trajtohen në mënyrë korrekte dhe me afat të shkurtër.	2019- process i vazhdueshëm	SA, NJA, ZSC , UMIB-i
Alumni.	Analiza e feedback-ut (treguesëve) të tregut rreth punësimit të studentëve të diplomuar.	Komunikimi me ish studentët dhe forcimi i shoqatave të të diplomuarve (alumni) me qëllim të promovimit të reputacionit të Universitetit brenda dhe jashtë vendit; Azhurimi vjetor i bazës së të dhënave të studentëve të diplomuar dhe mundësisht vëmendje ti kushtohet krijimi i një baze të dhënash për hukumtuesit e rinj që janë jashtë vendit.	Janar 2019 ne vazhdimesi	SA, NJA, ZZHC, UMIB-i



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

Ngritja e arritjeve të studentëve gjatë studimeve.	Inkurajimi i vazhdueshëm i përmirësimit të programeve të studimit (në përputhje me Deklaratën e Bolonjës dhe Zonën Europiane të Arsimit të Lartë).	Kontakti me institucionet ndërkombëtare; -Zhvillimi i bazës ligjore për bashkëpunim; -Zhvillimi dhe akreditimi i programit për studime ndërdisiplinore.	2019 - process i vazhdueshëm	SA NJA ZSC
Zhvillimi i sistemit të sigurimit të cilësisë.	Krijimi organizativ i sistemit të sigurimit të cilësisë. Për të mbështetur arritjen e qëllimeve të vendosura, duhet të krijohet një strukturë e përshtatshme organizative e cila do të integrohet në sistemin e sigurimit të cilësisë të arsimit të lartë në Universitet.	Emërimi i Komisionit të Cilësisë dhe hartimi i rregullorës për përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësi të Komisionit të Cilësisë.	2019 - process i vazhdueshëm	SA NJA ZSC PS
Zhvillimi i mekanizmit për sigurim të cilësisë.	Me qëllim të monitorimit të vazhdueshëm dhe përmirësimit të sistemeve të sigurimit të cilësisë në UMIB, duhet të zhvillohen mekanizmat përgjegjëse lidhur me këtë çështje.	Përcaktimi i mekanizmave për sigurimin e cilësisë nënkupton mekanizma të brendshëm për sigurimin e cilësisë së mësimdhënies, punës shkencore dhe profesionale. Vetëvlerësimi nënkupton krijimin e një procedure për vlerësimin e FE në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë të Republikës gjatë vitit akademik. Krijimi i analizës SWOT të secilit fakultet veç e veç, e mandej bazuar në raporte parciale, të përpilohet analiza e plotë SWOT e tërë FE. Vlerësimi i punës së shërbimeve profesionale.	2019- process i vazhdueshëm	SA NJA ZSC UMIB-i



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

Zhvillimi i Procedures së verifikimit të cilësisë së sistemit të Arsimit të lartë.	Me qëllim të sigurimit të efektivitetit të implementimit të sistemit të sigurimit të cilësisë, Duhet të zhvillohen, dokumentohen dhe zbatohen procedurat periodike të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm.	Përcaktimi i procedurës për kontrollin e brendshëm -auditimit i sistemit të sigurimit të cilësisë Përcaktimi i procedurave të auditimit të brendshëm të një sistemi të sigurimit të cilësisë që lejon verifikimin e brendshëm të efektivitetit të procedurave të tij në të gjitha nivelet dhe fushat e veprimit. Rezultati i auditimit të brendshëm është raport që shërben si bazë për procesin e verifikimit të jashtëm të pavarur të sistemit të sigurimit të cilësisë.	2019- process i vazhdueshë m	NJA ZSC SA
Vetëvlerësimi i cilësisë.	Vetëvlerësimi i cilësisë të realizohet (vëzhgohet) vazhdimisht gjatë gjithë vitit shkollor.	Anketimi (Sondazhet) i studentëve (vlerësimi i studentëve për mësimdhënie, metodave të mësimdhënies, metodat e vlerësimi në provim, programit të studimit dhe organizimi i studimeve, ekzaminimi i punës së shërbimeve administrative dhe profesionale ...) Anketimi i të punësuarve, Anketimi i studentëve të diplomuar, Zbatimi i procedurave të tjera të parashikuara me planin e vetëvlerësimit.	2019- process i vazhdueshë m	ZSC
Përfshirja e studentëve në sigurimin e cilësisë.	Përfaqësimi i studentëve në të gjitha proceset për sigurim të cilësisë në FE nëpërmjet rishikimit të programeve të studimit, departamentit, fakultetit, shërbimeve për studentë dhe në nivel Fakultetit ekonomik.	Hartimi i procedurave për përfaqësim të studentëve në Sigurim të cilësisë.	2019- process i vazhdueshë m	NJA ZSC PA



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

<p>Akreditimi i Programeve BSc dhe Msc</p>	<p>Studimet themelore, dhe Pasuniversitare sigurojnë Përvetësimin e arsimit të lartë bazuar në punën kërkimore shkencore.</p>	<p>Punimi i punës së Bachelor Masterit të jetë një kontribut i drejtpërdrejtë shkencor dhe paraqet bazën për të dëshmuar kompetencat e tyre shkencore lidhur me punimin.</p> <p>Shpërndarja e njohurive dhe interpretimi i arritjeve shkencore është po aq e rëndësishme sa edhe krijimi i saj, kështu që qëllimi i FE, nëpërmjet reformës së studimit të master, si cikli i dytëi arsimit të lartë, është grumbullimi i njerëzve që krijojnë dhe shpërndajnë njohuri.</p> <p>Rritja e suksesit të studimit, me qëllim të përfundimit të studimit brenda afateve të caktuara (zbatimin e masave për të inkurajuar progresin e vazhdueshëm sipas viteve përmes anketave, vlerësimin sipas kredive ECTS të arritura, në përputhje me programet e studimit).</p> <p>Rritja e numrit të Masterit të mbrojtura në FE,</p> <p>Inkurajimi dhe motivim i studentëve të bachelor-it të diplomuar me infomimin në kohë për të vazhduar studimet;</p> <p>Angazhimi i një numri të madh të profesorëve në mentorimin e studentëve për aritjet e e thirrjeve të stafit akademik dhe studentëve</p> <p>përmes punës profesionale të arritjeve shkencore-mësimore;</p> <p>Inkurajimi i botimit të punimeve të përbashkëta shkencore -</p>	<p>2019-2021</p>	<p>NJA ZSC FE SA</p>
--	---	--	------------------	----------------------------------



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

		studentë dhe mentorë (duke botuar të paktën 2 punime të përbashkëta çdo vit).		
Puna kërkimore – shkencore.	Puna kërkimore-shkencore bazohet në hulumtime themelore, aplikative dhe zhvillimore që grumbullon materiale shkencore, sistemon njohuritë ekzistuese shkencore, formon dhe paraqet arritjet shkencore. Ai punon në projekte shkencore vendore dhe ndërkombëtare, boton vepra në revista dhe punimet e mbledhjeve shkencore, si dhe aktivitete që lidhen me popullarizimin e shkencës nëpërmjet tribunave, tryezave të rumbullakëta, konferencave, simpoziumeve etj.	Rritja e numrit të publikimeve të botuara në revistat të indeksuara në bazat e bibliotekave relevante, në përputhje me Rregullat mbi kushtet për përzgjedhje në titujt shkencorë. Rritja e numrit të pjesëmarrjeve në projekteve shkencore vendore (të përcaktohet një rritje e realizueshme deri në fund të kësaj Strategjie, pra një plan trevjeçar); Rritja e numrit të pjesëmarrjeve në projekteve shkencore ndërkombëtare (të përcaktohet një rritje e realizueshme deri në fund të kësaj Strategjie, pra një plan trevjeçar Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar nëpërmjet krijimit të bashkëpunimit me institute të huaja kërkimore shkencore; Rritja e financimit të aktiviteteve shkencore për SA në thirrje shkencore; Mbajtja e forumeve shkencore në universitet, organizimin dhe pjesëmarrja në aktivitete për popullarizimin e shkencës; vendosjen e materialeve të duhura në faqen e internetit të FE;	2019- process i vazhdueshëm	SA NJA REKTORATI



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

		<p>Përfshirja e studentëve më të mirë në punën për projektet shkencore; Sigurimi i pajisjeve kompjuterike të nevojshme si mjet themelor në punën shkencore dhe kërkimore; Monitorimi dhe përmirësimi i programeve ekzistuese dhe blerja e programeve dhe aplikacioneve të reja të licencuara për kompjuter.</p>		
<p>Ngritja e arritjeve të studentëve gjatë studimeve.</p>	<p>Inkurajimi i vazhdueshëm i përmirësimit të programeve të studimit (në përputhje me Deklaratën e Bolonjës dhe Zonën Europiane të Arsimit të Lartë).</p>	<p>Kontakti me institucionet ndërkombëtare; -Zhvillimi i bazës ligjore për bashkëpunim; -Zhvillimi dhe akreditimi i programit për studime ndërdisiplinore.</p>	<p>2019 - process i vazhdueshëm</p>	<p>SA NJA ZSC</p>
<p>Zhvillimi i Procedures së verifikimit të cilësisë së sistemit të Arsimit të lartë.</p>	<p>Me qëllim të sigurimit të efektivitetit të implementimit të sistemit të sigurimit të cilësisë, Duhet të zhvillohen, dokumentohen dhe zbatohen procedurat periodike të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm.</p>	<p>Përcaktimi i procedurës për kontrollin e brendshëm -auditimit të sistemit të sigurimit të cilësisë Përcaktimi i procedurave të auditimit të brendshëm të një sistemi të sigurimit të cilësisë që lejon verifikimin e brendshëm të efektivitetit të procedurave të tij në të gjitha nivelet dhe fushat e veprimit. Rezultati i auditimit të brendshëm është raport që shërben si bazë për procesin e verifikimit të jashtëm të pavarur të sistemit të sigurimit të cilësisë.</p>	<p>2019-process</p>	<p>NJA</p>
<p>Zhvillimi dhe menaxhimi i burimeve (resurseve) materiale.</p>	<p>Përmirësimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e burimeve materiale të</p>	<p>Përmirësimi i pajisjeve me pajisje të TI (kompjuter, laptopë,projektorë,etj.),të punonjësve dhe studentëve, Përmirësimi dhe modernizimi i pajisjeve të laboratoreve, Blerja e softëareve të rinj /licencave dhe modernizimin e</p>	<p>2018-</p>	



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

		atyre ekzistuese, Rritja e fondit të bibliotekës me libra dhe revista profesionale, Në procesin e planifikimit të prokurimit të burimeve materiale për çdo vit të përfshihen të gjitha pjesët organizative në nivel të UMIB-it		
Të implementohen programet e diplomës në përputhje me nevojat e tregut. Të bëhen analiza të tregut për të identifikuar se cilat programe janë relevante me nevojat e tregut.	Identifikimi i programeve më të mira për zhvillim në pajtim me nevojat e tregut; Të sigurohet udhëzim dhe strukturë se çfarë diplomash nevojiten për të plotësuar nevojat e punësimit në Kosovë. Rishikimet periodike të programeve ekzistuese të studimit duke u bazuar në indikatorët të kërkesave të tregut të punës.	-Miratimi i programeve; -Zbatimi i marrëveshjeve; -Zhvillimi i kurrikulës; -Implementimi i zhvillimit të fakultetit. -Të krijohen komitete këshilluese për industri specifike brenda kornizës së njësive akademike të UMIB-it; -Bashkëpunimi me Odën Ekonomike të Kosovës. -Të institucionalizohen programet e praktikës si pjesë të kurrikulave. Baza ligjore të përshtatshme që përcaktojnë qartë të gjithë mekanizmat dhe instrumentet për sigurimin e programeve profesionale në pajtim me kërkesat e tregut.	2019 proces i vazhdueshëm	UMIB ZSC ZIK TI NJA- FE
Rritja e bashkëpunimit me sektorin Publik dhe privat	Zhvillimi marrëdhënieve interaktive për botën e tregut të punës dhe të ndërmarrjeve.	Të forcohet trekëndëshi i njohurive inovative në mes të edukimit, kërkimit dhe biznesit.	2019 – 2021	NJA ZSC SI FE UMIB-i



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

Përpilimi i organogramit të ri të stafit	Pregaditja e tabelës të strukturës organizative të ardhshme FE Definimi i detyrave të divizioneve dhe përditësimi i rregulloreve për stafin duke u bazuar në nevoja.	Draft rregullorja e re	2019 –2021	NJA-FE Rektorati
Ngritja e kapaciteteve dhe trajnimi i vazhdueshëm i SA dhe stafit administrativ të FE	Definimi i fushave ku nevojitet trajnimi. Kontaktimi i donatorëve ndërkombëtarë; Dërgimi i stafit në kurse të Shkathtësive gjuhësore dhe Kompjuterike.	Organizimi i punëtorive trajnuese; -Draftimi i programit për trajnim; -Kursset obligative për stafin.	2019 –2021	NJA-FE Rektorati
Transparenca dhe llogaridhënia e vazhdueshme.	Të jemi sa më transparent në paraqitjen e rezultateve të punës së arritur dhe në llogaridhënie.	Aplikimi i rregulloreve	2019 –2021	NJA-FE Rektorati
Përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve për stafin dhe studentin.	Ngritja e kapaciteteve të shërbimeve ndaj studentëve dhe të tjerëve.	Të ngritet numri i stafit administrativ sipas nevojave të FE.	2019 –2021	NJA-FE Rektorati



Republika e Kosovës
Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" Mitrovicë
Fakulteti Ekonomik
Plani Strategjik 2018-2021

Numri i punonjësve.	Të kujdesemi vazhdimisht për numrin te punonjësve (duke përfshirë profesorët, bashkëpunëtorët dhe stafi administrativ dhe profesional), vendosjen e një numri optimal të profesorëve në raport me numrin estudentëve, kujdesin për përfaqësimin e barabartët të profesorëve sipas profesioneve të mësimdhënies dhe cilësinë e standardit personal të punonjësve dhe studentëve.	Të harmonizojë politikën e personelit me nevojat dhe planet reale, sipas treguesve të ngarkesës së punës së profesorëve bazuar në strukturën e programeve të studimit.	2019 –2021	NJA Zyra e buri meve njerë zore FE UMIB-i
Sistemi informativ dhe mbështetja e UMIB-it.	FE në bashkpunim me Universitetin do të sigurojë grumbullimin, analizën dhe shfrytëzimin e informatave relevante lidhur me menaxhimin efektiv të mësimdhënies dhe aktiviteteve të tjera që realizohen.	Rritja e përdorimit efektiv të Web faqes së internetit të Universitetit dhe përdorimi i shërbimeve elektronike të Web të zhvilluara në universitet (Internet, Intranet). Zbatimi i SI për menaxhimin e dokumenteve, Zhvillimi i SI për përpunimin automatik të anketave, Zhvillimi i punës së SI, për shërbimet e studentëve, shërbimet kadrovike dhe lidhjet e SI.	2019 –2021	NJA ZIKP FE Rektorati